




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr. 24, datë 05.10.2023

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES SË PËRDORIMIT TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK, ME NR.1069 PROT., DATË 30.11.2017,
DHËNË ME VENDIM NR.19 DATË 16.11.2017 NGA KBU SEMAN,
SUBJEKTIT “FAVINA 1” SH.P.K**



Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhëniën me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

VENDOSI:

1. Miratimin e rinovimit të lejes së përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, me nr.1069 prot., datë 30.11.2017, dhënë me vendim nr.19 datë 16.11.2017 nga KBU Seman, subjektit “Favina 1” sh.p.k; me vendndodhje në përroin e Voskopojës dhe Shipskës, Bashkia Korçë, Qarku Korçë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC Voskopoja

Vepra e marrjes 1

- X = 549647; Y = 4501488; Z = 1156 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Prurja mesatare $Q_{mes} = 0.656 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja llogaritëse $Q_{llog} = 1.16 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike $Q_{eko} = 0.103 \text{ m}^3/\text{s}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q = 1.16 \text{ m}^3/\text{s}$

Vepra e marrjes 2

- $X = 549997$; $Y = 4502285$; $Z = 1157 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Prurja mesatare $Q_{mes} = 0.146 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja llogaritëse $Q_{llog} = 0.14 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike $Q_{eko} = 0.013 \text{ m}^3/\text{s}$
- Sasia e ujit që jepet në përdorim $Q = 0.14 \text{ m}^3/\text{s}$


Godina e Centralit

- $X = 547161$; $Y = 4504207$; $Z = 954 \text{ m.m.n.d. (KRGJSH)}$
- Vëllimi i rrjedhës së kthyer: $1.3 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN



LEFTER SHEHAJ